



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____ , Datë _____

PËR

**RREGULLAT DHE PËRMBAJTJEN E PLANEVE VJETORE
TË PRANIMIT DHE PROCEDURAT PËR PËRGATITJEN
DHE MIRATIMIN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të neneve 18 dhe 69, të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, me propozim të Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. - Ky vendim përcakton përmbajtjen, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planeve të pranimit për institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, si dhe procedurat e hollësishme për përgatitjen dhe miratimin e planit të përgjithshëm të pranimit për institucionet e administratës shtetërore.
2. - Vendimi i Këshillit të Ministrave, vendimet e institucioneve të pavarura dhe vendimet e organeve të qeverisjes vendore për planifikimin vjetor, duhet të përmbajnë:
 - a. - numrin e vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurimi për çdo kategori dhe klasë;
 - b. - grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm;
 - c. - institucionet ku planifikohen vendet vakante.
3. - Institucionet e administratës shtetërore/Institucionet e pavarura/njësitë e qeverisjes vendore, për planifikimin vjetor të pranimit në shërbimin civil, kanë parasysh:
 - a. - Mbushjen e moshës së pensionit të nëpunësit civil;
 - b. - Parashikimin e vendeve të reja në shërbimin civil;
 - c. - Ecurinë e krijimit të vendeve vakante në shërbimin civil për arsye të tjera të paparashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike.

4. - Institucionet në varësi të Kryeministrit apo ministrave, jo më vonë se muaji tetor i çdo viti kalendarik, i paraqesin Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave apo Sekretarit të Përgjithshëm të ministrisë nga varen, planin e nevojave për pranimet në shërbimin civil për vitin e ardhshëm. Nëse institucionet nuk kanë nevoja për rekrutim, ato vënë në dijeni zyrtarisht Sekretarin e Përgjithshëm nga i cili varen.
5. - Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në Kryeministri dhe çdo ministri, harton planin e konsoliduar të nevojave për pranim për të gjithë sistemin përkatës.
6. - Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave apo ministrive, brenda muajit nëntor i dërgon Departamentit të Administratës Publike planin e konsoliduar të nevojave për pranim për të gjithë sistemin përkatës.
7. - Departamenti i Administratës Publike, brenda muajit dhjetor, përgatit projektvendimin për planifikimin vjetor të pranimit për administratën shtetërore dhe ia paraqet atë Këshillit të Ministrave, jo më vonë se muaji janar i vitit pasardhës.
8. - Këshilli i Ministrave, jo më vonë se fundi i muajit shkurt, miraton planin vjetor të pranimit për institucionet e administratës shtetërore.
9. - Njësitë e qeverisjes vendore dhe çdo institucion tjetër i pavarur, jo më vonë se fundi i muajit shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore.
10. - Vendimi i Këshillit të Ministrave për planin vjetor të pranimit publikohet nga DAP në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”.
11. - Njësitë e qeverisjes vendore dhe institucionet e pavarura publikojnë vendimet për miratimin e planeve vjetore të punësimit në Portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqet e tyre dhe në ambjentet publike.

Ky vendim hyn në fuqi më datë 1 Prill 2014

KRYEMINISTRI

EDIRAMA